



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi të Shumta në Apache Tomcat

Data: 23/02/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	2
Referenca	2

Përmbledhje Ekzekutive

Janë identifikuar disa dobësi në Apache Tomcat dhe Apache Tomcat Native që mund të mundësojnë anashkalim të kufizimeve të sigurisë, anashkalim të autentikimit me certifikatë klienti dhe anashkalim të kontrollit të revokimit OCSP.

Informacione Teknike

Detaje të Dobësive:

CVE-2026-24733 — Anashkalim i Kufizimeve të Sigurisë përmes HTTP/0.9

- Rrezikshmëria: Low
- Apache Tomcat nuk kufizonte siç duhet kërkesat HTTP/0.9 vetëm te metodat e mbështetura. Në konfigurime të caktuara, kjo mund të lejonte anashkalimin e kufizimeve të sigurisë që mbështeten në validimin e metodës HTTP.

CVE-2025-66614 — Anashkalim i Verifikimit të Certifikatës së Klientit përmes Virtual Host Mapping

- Rrezikshmëria: Moderate
- Apache Tomcat nuk validonte përputhshmërinë midis hostname-it TLS SNI dhe header-it HTTP Host. Në ambiente me shumë virtual hosts, kjo mund të lejonte anashkalimin e autentikimit me certifikatë klienti në konfigurime specifike.

CVE-2026-24734 — Anashkalim i Kontrollit të Revokimit OCSP

- Rrezikshmëria: Moderate
- Kur përdoren responder-at OCSP, Apache Tomcat Native nuk verifikonte plotësisht validimin e përgjigjes OCSP, gjë që mund të lejonte anashkalimin e kontrollit të revokimit në kushte të caktuara.

Produktet e Prekura

- Apache Tomcat 11.0.0-M1 deri në 11.0.14
- Apache Tomcat 10.1.0-M1 deri në 10.1.49
- Apache Tomcat 9.0.0.M1 deri në 9.0.112
- Apache Tomcat 11.0.0-M1 deri në 11.0.17
- Apache Tomcat 10.1.0-M7 deri në 10.1.51
- Apache Tomcat 9.0.83 deri në 9.0.114
- Apache Tomcat Native 2.0.0 deri në 2.0.11
- Apache Tomcat Native 1.3.0 deri në 1.3.4

- Versionet më të hershme që janë End-of-Life mund të jenë gjithashtu të prekura.

Versionet e Rregulluara

- Apache Tomcat 11.0.15 ose më i ri
- Apache Tomcat 10.1.50 ose më i ri
- Apache Tomcat 9.0.113 ose më i ri
- Apache Tomcat 11.0.18 ose më i ri
- Apache Tomcat 10.1.52 ose më i ri
- Apache Tomcat 9.0.115 ose më i ri
- Apache Tomcat Native 2.0.12 ose më i ri
- Apache Tomcat Native 1.3.5 ose më i ri

Rekomandime

Rekomandohet përditësimi i versioneve të prekura në versionet e rregulluara ose në versionet më të fundit të publikuara nga Apache Tomcat.

Referenca

<https://tomcat.apache.org/security-10.html>